


TLAS



SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANË NË VITIN 2015

Botim i Shërbimit Ligjor Falas Tiranë

NUMRI TOTAL I ÇËSHTJEVE NË VITE Janar 1999 - Dhjetor 2015



Botimi i këtij materiali është
mbështetur financiarisht nga



MISIONI I TLAS

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) është regjistruar si organizatë jo fitimprurëse, e pavarur, me Vendimin Gjykatë Nr. 346, datë 18/12/2006, themeluar nga CAFOD UK.

TLAS ka filluar aktivitetin si program i Cafod Albania, që në vitin 1999 dhe vazhdon të ofrojë shërbim ligjor falas për kategoritë në nevojë për çështje civile.

Plotësimi i nevojave ligjore të njerëzve në nevojë, sensibilizimi i tyre mbi të drejtat themelore të njeriut, nxitja e ndryshimeve të sistemit ligjor, në funksion të përmirësimit të kushteve ekonomiko-sociale të individëve dhe grupeve vulnerabël.

OBJEKTIVAT E TLAS

- Të ofrojë shërbime të plota ligjore për shtresat në nevojë të shoqërisë;
- Të sigurojë që njerëzit në nevojë të kenë më shumë akses në sistemin ligjor;
- Të ndërmarrë inisiativa për përmirësime në legjislacion, advokim dhe lobbying për realizimin e tyre;
- Të ndikojë në përmirësimin e qeverisjes, përmes përfshirjes së grupeve vulnerabël;
- Të botojë të dhëna mbi probleme të rëndësishme ligjore dhe të të drejtave të njeriut, që janë ndeshur gjatë trajtimit të rasteve të klientëve të TLAS.

BORDI DREJTUES

Vangjel Kosta
Viktor Gumi
Dashamir Kore
Elton Lula
Shkelqim Bozgo

ADRESA & KONTAKTE:

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)
Bulevardi "Bajram Curri"
Pallatet Agimi, shk. 18, ap. 322, Tiranë - Shqipëri
Tel/Fax: +355 4 2258 442
Tel: +355 4 2253 114
Kutia Postare 69
E-mail: tlas@tlas.org.al
www.tlas.org.al

AKTIVITETI I SHËRBIMIT LIGJOR FALAS TIRANË (TIRANA LEGAL AID SOCIETY), TLAS, 2015


Nuk ka pasur ndonjëherë nevojë më të madhe për shërbimet e TLAS-it. Shifrat më të fundit të Institutit të Statistikave të Shqipërisë tregojnë se, që prej krizës ekonomike botërore dhe pas më shumë se për dhjetë vjetë shkalla e varfërisë ishte ulur, tashmë trendi është në drejtimin e kundërt. Jo vetëm që ka pasur rritje të numrit të personave që jetojnë nën limitin e varfërisë, por edhe është gati dyfishuar niveli i varfërisë ekstreme. Personat më të varfër dhe më në nevojë duhet të mbrohen nga ligji, por thuajse gjithmonë janë pikërisht ata që kanë më shumë vështirësi të marrin shërbimet që ju përkasin me të drejtë dhe që do të bënin një ndryshim të vërtetë në jetët e tyre.

Në këtë kontekst, janë nevojë e domosdoshme shërbimet ligjore falas. Mbrojtja ligjore strategjike sot është bërë një prioritet për të garantuar se ligji do

t'iu shërbejë atyre që kanë më shumë nevojë. Po aq e domosdoshme është edhe partneriteti efektiv midis organizatave që kërkojnë të ndihmojnë shtresat më të marginalizuara. Vitin e shkuar, TLAS-i mori përsipër të zgjidh 1296 çështje ligjore që përfshinin fëmijët, të papunët, personat me aftësi të kufizuara, pensionistët e varfër dhe familje të tjera në nevojë. Këta klientë kanë dhënë dëshmi që thonë se pa ndihmën që ju ka ofruar TLAS-i, do të ishin në një gjendje të keqe të paimagjinueshme. Vetëm në 2015, TLAS-i ka ndihmuar të regjistrohen 515 fëmijë, përndryshe, këta të fundit nuk do të njiheshin zyrtarisht dhe kjo do të sillte pasoja për shëndetin, mirëqenien dhe edukimin e tyre. Nisma jonë në terren për ligjin (Street Laë) ju ka ofruar këshillim falas komuniteteve më të varfra në gjithë vendin. Kemi trajnuar nëpunës të autoriteteve shtetërore vendore në mënyrë që t'i ndihmojmë të trajtojnë personat nga këto komunitete. Avokatët dhe paralegalet tanë tanë janë duke ndjekur kauza të

vecanta me synim shmangjen dhe ndreqjen e mangësive në ligj dhe si rrjedhojë të ndihmojnë sa më shumë persona.

Edhe pse financimi mbetet një sfidë e vërtetë, ne kemi shpenzuar vite për t'u bërë eficient dhe e dimë se tashmë ofrojmë shërbime ligjore me cilësi dhe kosto që nuk është në gjendje t'i ofrojë askush tjetër. Pikërisht këtë model po përpiqemi ta promovojmë në mënyrë që fondet qoftë të donatorëve apo të shtetit të përdoren sa më mirë për t'i shërbyer



sa më shumë individëve. Qëllimet tona për këtë analizë vjetore janë sa ligjore po aq edhe ekonomike e sociale. Ato synojnë nga njëra anë të mundësojnë ndryshimet e nevojshme në sistemin e drjtësisë, dhe nga na tjetër të ofrojnë ndihmën e shërbimet e përditshme për personat që kanë më shumë nevojë, të bëjmë ndryshim në shoqërinë shqiptare. Një nga synimet ka qënë dhe nxitja e profesionistëve të fushës juridike për t'u përfshirë për të ofruar shërbim ligjor pro-bono ose falas ndaj individëve vulnerabël . Së fundmi, TLAS-i pranon se asgjë nga puna që bën nuk do të ishte e mundur pa përkushtimin dhe angazhimin e ekspertëve, anëtarëve të stafit dhe vullnetarëve. TLAS-i beson se të gjithë njerëzit duhet të jenë të barabartë përballë ligjit; se drejtësia duhet të jetë njësoj për të gjithë dhe se duhet të ketë një sistem ligjor që është i lehtë për t'u kuptuar dhe për t'u zbatuar.

Prandaj TLAS gjatë vitit 2015 dhe në vazhdim ka patur si qëllim të parë strategjik: Aksesin dhe përfshirjen për të ndihmuar qytetarët të zgjidhin problemet ligjore dhe të mbrojnë të drejtat e tyre përmes:

- **Përcaktimit** me përparësi të llojeve të shërbimeve për fëmijët, familjet vulnerabël dhe qytetarët e tjerë të varfër.

- **Përmirësimit** të aftësive të klientëve për të zgjidhur vet problemet ligjore nëpërmjet trainimit individual dhe në grup me drejtues ose përfaqësues të komunitetit, nëpërmjet ofrimit të formularëve të gatshëm e të lehtë për t'u përdorur.

- **Identifikimit** të çështjeve ligjore përmes përdorimit të vet qytetarëve të TLAS ëeb portal, i cili synon të orientojë personat në nevojë si t'i zgjidhin ato. Ky program do të shërbeje për të mbledhur të dhëna për problemet që ndeshin qytetarët si dhe për të përcaktuar prioritetet ku duhet të mbështetet.


- Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS), ka gjetur mbështetjen e donatorëve, partnerëve, stafit, njerëzve në nevojë dhe personave të tjerë të interesuar për funksionimin e aktiviteteve të tij të larmishme. **TLAS gjatë vitit 2015 pati mundësinë të zgjerojë** strukturën e tij dhe së bashku me aktorë të tjerë qeveritarë dhe jo-qeveritarë është përpjekur të krijojë një realitet tjetër në funksion të zhvillimeve të mëtejshme të demokracisë në Shqipëri. Duke përfituar nga grantet e miratuar për 2015, TLAS e ka shtrirë shërbimin e tij jo vetëm në qarkun e Tiranës, por edhe në Fier, Elbasan, Durrës, Shkodër, Korçë, Berat dhe Gjirokastrë. Madje përmes shërbimeve ligjore mobile, seminareve të trajnimit, aktiviteteve të *street law*, *linjës telefonike lawline*, është bërë e mundur që të përfitojnë individë vulnerabël edhe nga rrethet tjera të largëta si Peshkopia, Gjirokastra, Kukësi, etj.

- TLAS edhe pse me staf të ri në moshë ka ofruar shërbim të kualifikuar në punën me klientët,

me rastet e ndjekura në rrugë administrative, në ato me rrugë gjyqësore, me rastet Kliniks dhe vecanërisht është për t'u theksuar si një risi puna me rastet strategjike.

- TLAS është anëtar aktiv i koalicionit Bashkë kundër Trafikimit të Fëmijëve, koalicioneve rajonale si **Ballkan Regional Rule of Law, BRRLN, European Network Statelessness, ENS, si edhe CHILD PACT.**

- **Aktiviteti i Shërbimit Ligjor Falas Tiranë (TLAS) gjatë 2015 është bërë i mundur në sajë të financimeve të Fondacionit të Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë (SOROS/OSFA); të UNICEF, UNDP, CRD (Civil Rights Defenders), Ambasada Australiane Rome, Vodafone Albania, Save the Children, etj.**




FUSHA E LIGJIT NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE


TLAS vazhdoi gjatë vitit 2014 të ofrojë shërbime ligjore për çështjet civile, administrative, familjare dhe të punës si dhe për rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut; në formën e këshillimit, dhe të përfqësimit si në organet administrative edhe në ato gjyqësore. Shërbimi Ligjor Falas i TLAS është i fokusuar tek familjet më të varfra, tek fëmijët vulnerabël, pensionistët, individë me aftësi të ndryshme, duke synuar për fshirjen e tyre sociale.

Numri total i përfituesve të drejtpërdrejtë nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, TLAS, gjatë 2014 ka qënë **1384** klientë, dhe numri total i të gjithë përfituesve të drejtpërdrejtë në vite ka arritur shifrën **18247** klientë, sic tregon dhe diagrama akumulative më poshtë:

NUMRI TOTAL I ÇËSHTJEVE NË VITE / Janar 1999 - Dhjetor 2015




Për të parë se cila kategori vulnerabël ka përfituar nga shërbimet e TLAS po japim të dhënat si më poshtë:



Përfituesit janë shërbyer si më poshtë:

Grupet e synuara	Paralegal	Avokat	Total
Fëmijët	374	141	515
Nena Kryefamiljare	81	79	160
Individë me aftësi të ndryshme	69	53	123
Të papunë	55	57	112
Të moshuar pa të ardhura	35	45	80
Pensionistë	34	41	75
Familje të tjera në varfëri	107	124	231
Total:2014	736	560	1296
Total: 1999-2014	10865	7356	19543

Përfituesit e TLAS sipas Llojit të Cështjes, 2015



Më poshtë paraqitet përqindja e suksesit të çështjeve të përfaqësuara përpara gjykatave dhe strukturave administrative:

Lloji i shërbimit të ofruar	Numri i rasteve	Mbyllur në favor të klientit
Përfaqësim në gjykatë	285	91%
Përfaqësim në Administratë	497	93 %
Shërbyer me kliniks	514	n/a
Total	1296	
Shërbyer përmes lawline	823	n/a



Llojet e Cështjeve janë trajtuar nga:

Lloji i Cështjes	Paralegal	Avokat	Total
Regjistrim lindje	374	141	515
Divorc	56	75	196
Cështje Familjare	95	52	255
Pensione	15	63	31
Pronësi	16	47	62
Strehim dhe transferime	88	43	19
Të drejta të tjera të njeriut	92	139	80
Total: 2015	736	560	1296



Objektivat e përcaktuara nga TLAS për 2015 janë arritur në përputhje me kontratat e nënshkruara me donatorët, edhe pse zhvillimet dhe ndryshimet e diktuar nga reformat e ndërmarrë kudo si në sistemin e ekonomisë, atë social, territorial apo të drejtësisë kanë qënë intensive dhe me efekte të drejtpërdrejta në jetët e familjeve apo individëve vulnerabël.

Me rëndësi të vecantë ka qënë për TLAS hartimi i Planit të Ri trevjeçar Strategjik për 2015-2017, i cili pozitivisht influençoi ndjeshëm për mbështetjen financiare të projekteve të TLAS gjatë 2015 dhe 2016.

Grupet vulnerabël të mbështetura dhe shërbyera nga TLAS kanë qënë, fëmijët vulnerabël, familjet e tyre si edhe të tjerë në kushtet e varfërisë përfshirë këtu minoritetin Rom dhe egjiptianë. Ndër **1296 përfituesit e drejtëpërdrejtë të shërbyer nga TLAS** gjatë 2015, **515 kanë qënë fëmijë, 414** janë familje të varfëra nga të cilat **151** janë gra kryefamiljare, **112 janë të papunë, 123** janë më fatësi të kufizuara dhe in-

valide, **75** pensionistë apo **80** janë të moshuar pa të ardhura të mjaftueshme për të jetuar.

Nga **560** çështjet ligjore të trajtuara nga avokatët e TLAS, **285** prej tyre janë përfaqësuar në gjykatë dhe **275** të tjerat janë trajtuar me shërbime kliniks¹.

Nga **736** çështjet ligjore që janë trajtuar me rrugë administrative, **497** prej tyre janë përfaqësuar para strukturave shtetërore të niveleve të ndryshme² dhe **239** prej tyre janë trajtuar po ashtu me kliniks. Çështjet që zgjidhen me mrrugë administrative janë kryesisht regjistrimet e lindjes së

¹ Shërbimet Kliniks presupozojnë shërbime ligjore të tipit këshillim, hartim dokumentash ligjore, kërkesë padish për në gjykatë, si edhe asistim hap pas hapi të klientit që vetë përfaqësohet para gjykatës. Shërbimet kliniks ju ofrohen klientëve të varfër por që janë të arsimuar dhe në gjendje të përfaësojnë vetveten para gjykatës.


² Në këtë grup përfshihen kryesisht individët dhe familjet e komunitetit Rom e Egjiptian, por edhe nga maxhoranca, të cilët nuk kanë as mundësitë ekonomike për të përballuar tarifa shtetërore qoftë edhe minimale, apo shpenzime të tjera të udhëtimeve për të siguruar dokumenta të nevojshme, por as kapacitetin për të ndjekur një procedurë nga fillimi në fund për të finalizuar çështjen administrative. Ky grup asistohet me kohë të plotë nga stafi paralegal i TLAS.

fëmijëve, strehimi, transferimi, martesat, ndihma ekonomike, si dhe aplikime të tjera për programe sociale të ofruara nga Shteti.

Një fushë sa e re edhe shumë e rëndësishme ku është fokusuar me suksese TLAS gjatë 2015 është trajtimi i një grupi rastesh strategjike.



STRUKTURA ORGANIZATIVE E TLAS PËR VITIN 2015 KA QËNË SI MË POSHTË



Rast Strategjik i dërguar te Komisioneri për Mbrotjen nga Diskriminim, KMD, i 9 familjeve të dëbuara nga Selita

Në 1 Prill 2015 në zonën ku jetojnë një numër I konsiderueshëm familjesh të komunitetit Rom, filluan punimet për ndërtime e unazës së re të Tiranës. Nga ky project preken shume familje Rome dhe jo Rome, të cilat jetojnë prej vitesh në këtë zonë.

Njoftimin për fillimin e projektit e dha Drejtoresha e Agjensisë për Strehimin, Mrs Doris Andoni, në prezencë të përfaqësuesve të Ministrisë së Mirëqënies dhe Rinisë, të Kabinetit të Kryeministrit dhe të banorëve që preken nga ky ndërtim. Në këtë takim u njoftuan procedurat që do të ndiqen në zbatim të VKM, datë 13.03.2015, Nr 230, " Rreth sigurimit të pagesës së qirave të familjeve që preken nga ndërtimi i bypasit të rrugës Komuna e Parisit--Rruga e Kavajës". Sipas përfaqësuesve të shtetit , ky vendim i Qeverisë e zgjidhte problemin e strehimit të këtyre





banorëve për dy vjetë. Ky njoftim shkaktoi me shumë të drejtë zemërim të madh te banorët të cilët reagueshan ashpër duke mos u dakordsuar me zgjidhjen e propozuar apo me vendimin e marrë.

Banorët na njoftuan dhe avokatët e TLAS u paraqitën menjëherë në takim duke konkluduar se masat që propozohen nga përfaqësuesit e shtetit janë sa kontradiktore aq edhe diskriminuese.

Prandaj më TLAS pasi e studjoi me vemendje çështjen, e cila ishte e ndryshme dhe specifike

për secilën nga familjet e prekur arriti në konkluzionin që familjet nuk mund të trajtohen njëloj bazuar në VKM 230. Nga një klasifikim I bërë dilte se një grup familjesh mund të trajtohej me bonus qeraje të siguruar nga Bashkia, sepse ato familje nuk kishin asnjë document që ishin banorë të zonës apo që kishin pronësi, apo që kishin përgatitu dokumenta për legalizim të barakave që përdornin sio bane-sa. Po një grup tjetër ishin ata që qartazi dispononin dokumenta dhe të drejtën për t'u kompnesuar nga Shteti për shpronësim, dhe jot ë diskriminoheshin duke i larguar me një kontratë qeraje

të paguar vetëm për dy vjetë. Për këtë grup familjesh u përgatit ankimimi i depozituar para Komisionerit për Mbrijtjen nga Diskriminimi. Më datë 30.07.2015 u zhvillua një séance degjimore nga Komisioneri lidhur me ankesën e bërë nga Shërbimi Ligjor Falas TLAS në emër të përfaqësuesve të komunitetit Rom dhe Egjiptian që jetojnë në zonën e Selitës e që preken nga Projekti I ndërtimit të unazës së madhe të Tiranës.

Në séance, TLAS përfaqësohej nga Av. Anisa Metalla dhe nga subjektet e ankuara ishin prezente znj. Albana Tallkuçi,

Shefe e Sektorit të Planifikimit Urban ALUIZNI, znj. Doris Andoni, Drejtore e Përgjithshme e Entit Kombëtar të Banesave dhe znj. Ermira Tanço, specialist nga Drejtoria e shërbimeve Urbane dhe Strehimit pranë MMSR.

Ankesa drejtuar Komisionerit përmban adresimin e disa aspekteve themelore që lidhen me mënyrën si janë trajtuar familjet që preken nga ndërtimi I projektit, të cilat në thelb janë diskriminuese për banorët. Trajtimi I këtyre familjeve me pagesë qiraje për dy vjetë sipas parashikimeve të bëra në VKM nr. 230 datë 13.03.2015, nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare e po ashtu me detyrimin e shtetit për Respektimin e Lirive e të Drejtave Themelore të Njeriut. Këto qendime i janë bërë të ditura institucioneve vendimmarrëse shtetërore pas komunikimit të VKM-së së sipërcituar, nëpërmjet një relacioni të përbashkët të Organizatave të Shoqërisë Civile (Qendra Republika, Sherbimi Ligjor Falas, Komiteti Shqiptar I



Helsinki, Civil Rights Defenders, OSFA).

Parë në këndvështrimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi e të praktikës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut për rastet e dëbimeve/shpërnguljeve duhet të mbahen në konsideratë këto elemente:

- Shpërnguljet / dëbimet janë në kundërshtim me të drejtat e njeriut;

- Ato mund të përligjen vetëm në raste përjashtimore dhe në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare;

- Ato mund të lejohen vetëm nëse kryhen për të nxitur mirëqenien e përgjithshme, kryhen në përputhje me parimet e arsyes dhe proporcionalitetit si dhe nuk bëhen me diskriminim;

- Dëbimi nuk duhet të sjellë pasojën që individët të mbesin të pastrehë apo të bëhën vulnerabel ndaj shkeljeve të tjera të të drejtave të njeriut;

- Shteti duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme që të garantojë strehim të përshtatshëm alternativ;

- Shteti dhe legjislacioni i tij duhet të ofrojnë një mbrojtje ligjore efektive kundër dëbimeve dhe duhet që personat e prekur të kenë akses në një sistem efektiv të mbrojtjes dhe në një procedurë të rregullt ligjore;

- Banesat e levizshme hyjnë në konceptin e banesës sipas nenit 8 të KEDNJ;



- Nëse personat dëbohen nga këto vendbanime dhe nga komuniteti, banesa dhe jeta familjare e tyre do të cënoheshin;

- Në parim, është konsideruar e ligjshme për autoritetet, për qëllime të zhvillimit urban, të përpiqen të rifitojnë tokën apo truallin nga persona që e kanë zënë atë në mënyrë të paligjshme. Por kur autoritetet për një periudhë të gjatë i kanë toleruar vendbanimet e pa ligjshme të romëve, i kanë lejuar të zhvillojnë lidhje të forta me vendin dhe të ndërtojnë aty një

jetë në komunitet, ky fakt merret në konsideratë;

- Nuk ekziston një detyrim për shtetet të sigurojnë strehim për kërkuesit (sipas Konventës), megjithatë nga neni 8 i saj mund të rrjedhë një detyrim për të siguruar strehim për individë veçanërisht vulnerabël;

- Është për t'u theksur detyrimi që vjen për shtetin që të sigurojë mjete të strehimit alternativ, siç mund të jetë legalizimi i bane-save kur është i mundur, apo dhënia e ndihmës për të gjetur strehim alternativ kur shpërngulja/dëbimi është i nevojshëm;

- Shteti duhet të konsiderojë gjithmone riskun e mbetjes të pastrehë të personave si pasojë e dëbimit;

- Romët veçanërisht duhet të shihen si grup social i paavantazhuar;

Duke mos marrë në konsideratë elementët e mësipërm zgjidhja e ofruar nga shteti i ka



vënë ankuesit dhe komunitetin Rom dhe Egjiptian të zonës së Selitës në Tiranë, në një situatë të disfavorshme me banorët e tjerë që jetojnë aty. Ata për shkak të specifikave që kanë si komunitet nuk kanë të njëjtën lehtësi si personat e tjerë jo-pjestarë të komunitetit, për të patur akses në të drejtën për të marrë një banesë më qira. Kjo për shkak edhe të numrit të madh të pjestarëve që ka në përbërje një familje, për shkak të mohimit dhe diskriminimit që në përgjithësi ka shoqëria ndaj tyre, vështirësia për të gjetur një banesë të përshtatshme është shumë më e madhe.

Në ofrimin e zgjidhjes, shteti nuk është ofruar të jetë palë në këtë proces, pra duhet të ishte shteti ai që duhet të kishte gjetur banesat e përshtatshme e po ashtu duhet të kishte menduar edhe për kostot ekonomike të procedurave ligjore, si hartimi i kontratës së qirasë, shpenzimet për transferimin e gjendjes civile të personave nëse do të ishte e nevojshme etj.

Për shkak të gjendjes arsimore e shoqërore e familjare, kushteve të banimit, mënyrës së jetesës për një kohë të gjatë, për këtë komunitet është tërësisht e paparashikueshme se si do të sillen me një shumë të ardhurash që i ka ofruar shteti në mënyrë të mënjëherëshme. Nuk është e garantuar që këto të ardhura do të përdoren vërtetë për të gjetur një banesë më qira nga kryefamiljari, për këtë shkak brenda një familje të tillë mund të ketë shpërdorime dhe pamundësi menaxhimi duke rritur efektivisht gjendjen e riskut sa i takon





fëmijëve, qëndrushmërinë e tyre në ushqim, në organet shëndetësore apo në shkolla. Kjo i vendos fëmijët e këtij komuniteti në një situatë tërësisht të disfavorshme në raport me fëmijët e tjerë.

Përfundimisht, sikurëse është përmendur edhe më sipër, zgjidhja e ofruar nga shteti nuk është e sigurve dhe e qëndrueshme, siç duhej detyrimisht të ishte. Ajo nuk i jep një zgjidhje përfundimtare të drejtës për strehim të këtyre famijeve, por është një zgjidhje e përkoshme. Pa siguria për të gjetur një banesë i vë këta persona në një pozitë

të diskriminuar. Këto elemente legjitimojnë diskriminimin e tërthortë i cili në thelb është "ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e pa anshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë".

Në kontekstin e Shqipërisë, ndër të tjera vlen të përmendim disa nga detyrimet të cilat ka marrë përsipër Shteti Shqiptar për të zbatuar. Këto bazuar (konkre-tisht) në disa përfundime të seminarit "Shqipëri-BE, për dialogun politik mbi përfshirjen e komunitetit Rom dhe Egjiptian: Sfida të reja në zhvillim social të

Shqipërisë". (20-21 shkurt 2014), konkluzionet e të cilit janë botuar në faqen zyrtare të Delegacionit të BE-së më 10.03. 2015, organizuar në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme për zgjerimin e Komisionit Evropian. Sipas raportit përfundimtar, çështjet e strehimit dhe infrastrukturës që do të sqarohen më tej, gjatë Zhvillimit të Planit të Veprimit - nga MMSR me MZHUT dhe Ministria e Drejtësisë do të jenë:



- Rishikimi i legjislacionit ekzistues dhe ndryshimi i tij, në mënyrë që të sigurojë respektimin e sundimit të ligjit (përfshirë strehimin alternativ dhe ndihmën sociale) në rastet e zhvendosjes të komunitetit rom dhe egjiptian në përputhje me Udhëzimet ndërkombëtare të dëbimeve të detyrueshme. Kjo çështje do të ndiqet në bashkëpunim me MMSR dhe njësitë e qeverisjes vendore.

- Hartimi i një akti ligjor për dëbimin me forcë nga Ministria e Drejtësisë, duke përfshirë aktorët e linjës.

- Gjatë planifikimit dhe miratimit të projekteve në ndërtimin e veprave të mëdha publike që përfshin shkatërrimin e shtëpive, autoritetet duhet të llogarisin shpenzimet për kompensim jo vetëm për shtëpitë e ndërtuara sipas Ligjit për Shpronësim, por edhe për shtëpitë që nuk kanë të drejtë për shpronësimin për shkak të statusit, si ndërtime të paligjshme. Vlerësimet e koston duhet ti paraqiten Ministrisë të Zhvillimit Urban dhe Turizmit (MZHUT) që të përfshihen në buxhetin e projektit.



Prandaj mbështetur dhe në këto direktiva nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, KMD, bazuar në argumentat e parashtruara u kërkua:

- MZHUT duhet të jetë e përfshirë në gjetjen e alternativave të strehimit.
- Duhet të krijohen politika dhe udhëzime mbi parandalimin e dëbimeve. Institucionet e qeverisjes vendore dhe qendrore duhet të trajnohen mbi procedurat që do të ndiqen në rastin e dëbimeve.
- Të sigurohet zgjidhje ligjore për komunitetin rom dhe egjiptian që aktualisht jetojnë në vendbanime informale dhe nuk kanë të drejtë për legalizimin e banesave. Ligji i ri për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje duhet të rishikohet për të marrë parasysh të gjithë grupet vulnerabël.
- Të mos ndermerret asnjë veprim nga autoritetet pa u zgjidhur më parë strehimi i qëndrueshëm i banorëve;
- Te zgjidhet gjetja e banesave me qira për familjet gjatë periudhës 2 vjeçare;
- Marrja e masës së detyrimit të autoriteteve për gjetjen e një zgjidhjeje efektive për të strehuar me banesa komunitetin pas periudhës dy vjeçare të trajtimit me pagesë qiraje parashikuar në VKM nr. 230 dt. 13.03.2015 "Për trajtimin me pagesë tëqirasë për disa familje që preken

nga zbatimi i projektit “Unaza e madhe e Tiranës, segmenti “Komuna e Parisit-Rruga e Kavajës”.

Vlen të theksohet se pothuajse çdo vit paraqiten shumë klientë të cilët kërkojnë të drejtën e tyre në lidhje me pronën dhe kryesisht këto konflikte shkaktohen nga vendimet e padrejta të Komisioneve të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave si dhe të Agjensisë së Kthimit të Pronave. Duke qenë se klientët nuk e kanë realizuar të drejtën e tyre gjatë procedurave administrative pranë Komisioneve dhe Agjensisë i drejtohen gjykatave me kërkesë padi për të kundërshtuar këto vendime. Për këtë kategori përgatiten kërkesë paditë për t’iu drejtuar gjykatës si dhe çdo dokument të nevojshëm ligjor i cili është i domosdoshëm gjatë procedurës gjyqësore.

Gjithashtu me shërbim kliniks janë trajtuar mjaft raste administrative siç janë rastet kur qytetarëve të ndryshëm u refuzohet dhënia e dokumen-

tave pranë zyrave shtetërore pa pasur një kërkesë me shkrim ose kur këto dokumenta duhet të paraqiten në gjykatë dhe i është kërkuar domosdoshmërisht një kërkesë me shkrim nga një avokat i licencuar.

Mund të themi se raste të tilla në qendrën tonë janë të shumta për çështje nga më të ndryshmet duke filluar që nga përgatitja e kërkesave për tërheqje certifikatash për proçese gjyqësore, përgatitje kërkesash për tërheqje certifikatash lindjeje pranë materniteteteve, përgatitje kërkesash për kthim përgjigje me shkrim pranë institucioneve të ndryshme shtetërore të cilat janë të nevojshme për hapjen e një proçesi gjyqësor.



Histori të vërteta, ndeshur nga stafi i TLAS gjatë vitit 2015

Histori e Vërtetë I

Rast Strategjik: L.P

AS, nëna e LP, paraqitet tejet e tronditur në zyrat e TLAS, ajo vinte nga komuniteti Rom në Shkozë, Tiranë. Ajo filloi të tregojë se vajza e saj, L.P, ishte vetëm 5 vjece, kur për shkak të një temperaturë shumë të lartë, është shtruar në repartin e urgjencës në Qendrën Spitalore Universitare " Nënë Tereza" Tiranë e shoëruar nga gjyshja e saj. Mjeku i urgjencës pasi ka vizituar pacienten, duke parë gjënd-



jen e saj të rëndë shëndetësore, ka vendosur trajtimin e saj me antipiretik paranteral (Paracetamol intramuskular, injeksion) si dhe perfusion (serum) për përmirësimin e gjëndjes së saj klinike. Me zbatimin e këtyre rekomandimeve u mor infirmjerja e turnit. Në momentin e bërjes së injeksionit nga infirmjerja, vajza e vogël, ka reaguar menjëherë, duke qarë deri në nxirje, ndërsa këmba e majtë i ka ngelur e ngrirë. Pas kësaj infirmjerja ka thirrur menjëherë mjekun që kishte bërë rekomandimin. Ky i fundit ka vizituar klienten L.P dhe ka konstatuar se këmba ku ishte bërë injeksioni kishte humbur ndjeshmërinë. Në ditët në vazhdim fëmija L.P ka qëndruar në spital, me qëllim rikuperimi të këtij deficiti neurologjik i cili sillte si pasojë probleme në ecje. Pas shtrimit 10 ditor kjo paciente ka dalë nga spitali me rekomandimin për në KEMP.

A.S, nëna e fëmijës u paraqit në zyrën tonë pas kishte filluar procedimin penal në propkurori duke kërkuar asistencën e zyrës në këtë

proces. Ajo u këshillua nga avokatët e TLAS hap pas hapi për ndjekjen e kësaj procedure të nisur në prokurori dhe njëkohësisht u këshillua që në momentin e mbylljes së procesit penal, TLAS do të hapte çështjen civile për mjekim të gabuar dhe për dëmshperblim të dëmit të shkaktuar tek fëmija LP. Dhe kështu ndodhi, në përfundim të procesit penal infirmjerja e turnit u shpall fajtores për veprën penale të “Mjekimit të pakujdesshëm”, dhe u dënua me gjobë, ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Menjëherë pas këtij momenti nëna AS u këshillua nga avokati e TLAS që të kërkonte shperblimin e dëmit jashtëkontraktor nga institucioni spitalor tashmë në një proces gjyqësor civil, përmes hartimit me shumë kujdes të kërkesëpadisë dhe mbledhjes së provave. Në kërkimet parashtuar gjykatës u argumentua se paditësjka ka pësuar një dëm në shëndet. Gjithashtu nga vendimet penale të arësytuara për këtë rast është e vërtetuar lidhja shkakësore mes veprimit dhe pasojës së ardhur në



shëndetin e paditëses nga infirmjerja e institucionit spitalor, në këtë rast shkaktimi i paralizës së menjëhershme të këmbës, si pasojë e veprimit mekanik të ndërhyrjes me injeksion, të bërë në mënyrë jo profesionale nga infirmjerja.

Për këtë qëllim u kërkua **shperblimi i Dëmit jopasuror** i cili përfshin çdo lloj dëmi të pësuar nga cënimi i të drejtave dhe intereseve jopasurore që bëjnë pjesë në vlerat e njeriut dhe që nuk janë subjekt vlerësimi të drejtëpërdrejtë ekonomik në treg. U argumentua shkencërisht që dëmtimi i shëndetit është objekt kërkimi



dhe dëmshpërblimi i pavarur nga dëme të tjera pasurore e jopasurore të pësuar nga i demtuar për shkak të të njëjtit fakt të paligjshëm. Në rastin e fëmijës L.P, dëmtimi i shëndetit apo dëmi biologjik që ka ardhur si pasojë e faktit të paligjshëm, është pasoja e parë direkte që ka ardhur dhe nga e cila lind e drejta e dëmshpërblimit.

U kërkua shpërblim në kuptim të Dëmit **moral i pasqyruar** si shfaqje e brendshme, e përkohshme, e turbullimit të padrejtë të gjendjes shpirtërore të njeriut, dhimbjeje e vuajtjeje shpirtërore apo gjëndje ankthi që rrjedh si pasojë e faktit të

paligjshëm. Sepse në bazë të ligjit cilido që pëson çënime në sferën e shëndetit dhe të personalitetit të tij nga veprimet a mosveprimet e paligjshme dhe me faj të një të treti ka të drejtën të kërkojë edhe dëmshpërblimin e dëmit moral të pësuar. Vajza e vogël, 5 vjece, LP ka pësuar një tronditje të thellë si pasojë e dëmit dhe paaftësisë që i është shkaktuar duke kaluar nga gjëndja normale kur ecte, vraponte e kërcente në gjëndjen e paralizuar, kur njëra nga këmbët e saj është kthyer në një trung të palëvizshëm. Shpesh herë ajo shfaqet e vetmuar në përditshmërinë e saj pasi ndjen dhe vuan dallimin fizik që ka pësuar, vuan faktin që nuk mund të luaj me moshatarët, është izoluar dhe ka shfaqje të depresionit mendor.

Prandaj për LP u kërkua edhe Dëmi ekzistencial i shkaktuar nga fakti i paligjshëm i të tredit që çënon të drejtat e personalitetit të njeriut duke dëmtuar thuajse në mënyrë të përhershme shprehjen dhe realizimin e të dëmtuarit si njeri, shfaqjen e personalitetit të tij në botën e jashtme, duke trondi-

tur objektivisht jetën e përditshme dhe veprimtaritë e zakonshme të tij, duke i shkaktuar përkeqsim të cilësisë së jetës nga ndryshimi dhe prishja e ekuilibrit, sjelljes e zakoneve të jetës, të marrëdhënieve personale e familjare. Për shkak të një gjëndjeje të tillë psiko-fizike, i dëmtuari nuk mund të kryejë më veprimtari të caktuara që karakterizojnë pozitivistin qënien e tij apo që mund t'a karakterizojnë pozitivistin në të ardhmen, duke e detyruar të heq dorë nga pritshmëritë e rritjes dhe zhvillimit normal, për shkak të vërtetimit të faktit të paligjshëm.

Dëmi ekzistencial, duke mos patur natyrë thjesht ndjesore e të brendshme, ishte objektivisht i vërtetueshëm në rastin e klientes L.P., duke qënë e mitur dhe në formim të vazhdueshëm të fizikut dhe personalitetit të saj, gjëndja e paaftësisë së saj fizike i shkaktonte vuajtje dhe mundim në procesin e saj të rritjes duke ndikuar në vlerësimin dhe konsiderimin e vetvetes. Ky dëmtim i pësuar pengon në mënyrë të vazhdueshme shfaqjen e saj të jashtme si njeri, veprimtaria e saj e përditshme është tronditur, duke e penguar të jetojë fëmijnë, të luajë, të ecë të vrapojë.

Gjatë **grykimit të kësaj çështje** TLAS arriti të përjashtojë atë nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore si dhe taksës 3% e vlerës së objektit të padisë, e detyrueshme për t'u paguar për çdo çështje të kësaj natyre. Gjykata bazuar në gjëndjen shëndetsore të klientes (duke qënë se ajo tashmë është një person me aftësi të kufizuara) si dhe duke mbajtur në konsideratë gjëndjen ekstreme të varfërisë së klientes së mitur dhe familjes së saj, vendosi përjashtimin nga taksa. Kjo ishte një arritje shumë e madhe në këtë çështje pasi në shumë pak raste praktika gjyqësore shqiptare ka lejuar përjashtimin nga



taksa me arsyetimin se ligjërisht nuk ka një praktike dhe rregullim specifik për raste të tilla. Pas disa seancave gjyqësore rasti ka përfunduar në favor të LP. Pasi është kryer dhe një akt ekspertimi nga i cili është vlerësuar dëmi i shkaktuar klientes në vlerë monetare. Gjykata në fund të gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor dhe në Gjykatën e Apelit, vendosën pranimin e kërkesës dhe kompensimin e dëmit në masën 3,591,000 lekësh, në favor të LP.

Procesi gjyqësor për rastin LP është hapur në Maj 2013, dhe ka përfunduar në Mars 2015. Vendimi i gjykatës është ekzekutuar në Maj

2015, që do të thotë se pas një kohëzgjatje prej dy vjetësh në të dy shkallët e Gjykatës në Tiranë, vajza e vogël LP dhe familja e saj e varfër, pjesë e minoritetit Rom në Tiranë, arritën të marrin një dëmshpërblim si kompensim i **dëmit të shkaktuar prej 3, 591,000 lekesh.**

Nuk kishte ndodhur anjëherë deri më sot që një familje ekstremisht e varfër nga komuniteti Rom të mund të ndiqte një proces gjyqësor për dëmshpërblim të dëmit të shkaktuar nga mjekim i pakujdesshëm, edhe pse raste të tilla janë konstatuar dhe janë të konsiderueshëm në numër. Një precedent i tillë i realizuar nga Shërbimi Ligjor Falas është një mësim **për ndëshkueshmërinë e personelit mjekësor**, i cili me pakujdesinë e tij merr në qafë jetë njerëzish dhe fëmijësh, i cili përdor çdo mjet financiar për të mbrojtur veten, dhe bën që edhe kauzat e ngritura të dështojnë, bazuar në marrëdhëniet korruptive me gjykatat apo dhe me avokatët privat. Prandaj dhe **kjo çështje është strategjike dhe e një e një rëndësie të veçantë** pasi fenomeni i pandëshkueshmërisë



për raste të individëve që vijnë nga shtresat vulnerabël janë raste që pothuaj nuk arrijnë të hapen në gjykatë ose edhe kur hapen në gjykatë nuk arrijnë të finalizohen. Po ashtu u krijua në **precedent i rëndësishëm në praktikën gjyqësore sa i takon përjashtimit nga taksa gjyqësore të personave të varfër.**

Përgatiti
Anisa Metalla
Avokate e TLAS



Histori e Vërtetë II

Rasti: M.A

M.A. është bërë një kliente e rregullt e TLAS, që po ndihmohet të zgjidhë një sërë problemesh familjare. Së pari ajo nuk ka një identitet, thotë se është 31 vjece dhe nuk figuron e regjistruar në zyrën e gjendjes civile. MA ka vetëm një të dhënë nga prindërit, atë të babait të saj i cili quhet ShA i cili figuron me leje banimi në Kashar që prej lindjes së saj. Prandaj filluam përpjekjet për të kontaktuar të jatin e saj, por doli se SHA kishte ndërruar jetë në vitin 2014. Kështu dëshmitari dhe burimi i vetëm që

mund të jepte koordinata apo të dhëna të përafërta si vendin e lindjes, datëlindjen, nëse ka lindur në institucion apo jashtë institucionin nuk jetonte më.

Nga ana tjetër në bazë të dokumentave mjeksore dhe gjëndjes faktike, MA është në rrezik për jetën, është e diagnostikuar me kancer të gjirit dhe po vuan prej 4 vjetësh. Njëkohësisht sapo ka sjellë në jetë një fëmijë. MA ne fakt ka lindur më parë edhe një fëmijë tjetër rreth 7 vjec, në Gjermani, dhe thotë që e ka birësuar, por me shumë gjasa e ka braktisur sepse nuk mundet një njeri pa identitet të të braktisur tek njerëz të panjohur. Kjo do të thotë se MA është treguar e pakujdeshme për të ditur fatin e fëmijës së vet dhe që të njëjtin fat mund ta ketë dhe fëmija i porsa lindur për sakohë ajo nuk ka vet identitet dhe nuk mund të përgjigjet para ligjit. Tani ajo jeton në Tiranë, por deri para një viti ka jetuar në Gjermani, ku kishte emigruar ilegalisht. Pasi është identifikuar në Gjermani si emigrante ilegale, ajo është deportuar brenda 10 ditëve për në Shqipëri, dhe hyri



në kufijtë e Shqipërisë rreth datës 20 Shkurt 2015. Menjëherë ajo i drejtohet Qendrës Spitalore për të marrë ndihmë mjekësorë, por Qendra Spitalore nuk i ofroi asnjë shërbim shëndetësor sepse nuk kishte mjet identifikimi. Në këto kushte MA paraqitet në zyrën e TLAS, u intervistua me kujdes dhe doli që kishte një sërë problemesh ligjore komplekse, të ndërlydhura me njëra tjetrën, dhe që duhet të zgjidheshin hap pas hapi.

Se pari në mungesë të dokumentave nga institucioni shëndetësor i lindjes, për të regjistruar këtë nënë 31 vjecare në zyrën e gjëndjes civile, provuam të aplikojmë udhëzimin e MPB, nr.7 datë 10.01.2012, për regjistrimin e fëmijëve të gjetur. U plotësuan një sërë dokumentashy si vërtetimi nga kryeplaku i fshatit Kashar ku jetonte familja e të jatit; u mor vërtetimi nga Qendra Shëndetësore e Kasharit, që evidentonte se MA ishte trajtuar me kujdes shëndetësor, por proces verbali tip Modeli 3 në zbatim të udhëzimit nr. 10 nuk u plotësua nga zyra e gjëndjes civile Kashar me argumentin se është e



ritur, edhe pse ligji i sipër cituar nuk e përcakton një arsyim të tillë.

Së dyti, në këto kushte ruga e vetme ishte të përgatitej kërkesa për në Gjykatë që të fillonin procedurat gjyqësore për vërtetimin e faktit të lindjes përmes dëshmitarëve. Dëshmitari kryesor u kërkua dhe në trungun e babait u gjet që këtë rol mund ta merrte xaxhai i saj i cili do të ishte kërkuesi për hapjen e procedurave gjyqësore. Gjyqi ka filluar në datën 04/11/2015. Gjyqtari i çështjes Bledar Abdulai nuk i kushton vëmendje dhe

interes çështjeve të tilla sensitive si rasti i një nëne me kancer, pa shtetësi, me mungesë identiteti, që dhe që pa dyshim është nga rastet me shfaqjen më të theksuar të diskriminimit dhe mohimit të të drejtave themelore të njeriut. Procesi vazhdon dhe pse ky proces kondicionon mbijetesën, sepse kjo grua nuk akseson programin e ndihmës ekonomike, as ato shënetësore, dhe mos regjistrimi i saj pengon regjistrimin e lindjes së djalit, që sot është 5 muajsh. Të gjitha këto fakte njerëzore të kësaj gruaje, i janë bërë të njohura punonjësit të gjëndjes civile, dhe

më pas gjyqtarit por, të dy palët kanë mbajtur qëndrime krejtësisht të ftohta ndaj shëmbullit konkret, me pasojë njëri refuzimin për ta zgjidhur çështjen administrativisht dhe shpejt, apo tjetri qëndimin tejet indeferent duke e stërzgatur procesin gjyqësor përmes caktimit të një seance në cdo 45 ditë, në kundërshtim me ligjin për administrimin e çështjeve gjyqësore që thekson se seanca nga seanca duhet të zgjasë 10 deri në 15 ditë.

Emirjana Dimo
Avokate e TLAS



Histori e Vërtetë III

Rasti i F.P dhe L.P

F.P dhe L.P u paraqitën në zyrën e TLAS për t'u keshilluar lidhur me problemin e nipërve të tyre. Ata i përkisnin komunitet Rom dhe prej shumë vitesh kujdeseshin për dy fëmijë të mitur përkatesisht të moshave 7 dhe 4 vjec. Këta fëmijë kishin ardhur në jetë nga bashkëjetesa e djalit të tyre B.P me shtetasen Dh.S. Pas lindjes së fëmijës së dytë nëna e fëmijëve largohet nga banesa duke i braktisur fëmijët, ndërsa i ati i fëmijëve largohet drejt shtetit Grek dhe krijon familje tjetër duke ja lënë prindërve të tij fëmijët për rritje dhe edukim.

Fëmijët që të dy ishin të paregjistruar në zyrën e gjëndjes civile, sepse asnjëri nga prindërit dhe vecanërisht nëna e tyre nuk ishte paraqitur në zyrën e gjëndjes civile me dokumentin e asistencës në lindje. Ajo nuk kishte lënë as dokumentat e maternitetit për të orientuar gjyshërit lidhur me datën, mu-

ajin, vendin e lindjes së fëmijëve. E drejta e regjistrimit i është dhënë me ligj vetëm prindërve, por për fatin e keq të fëmijëve prindërit e tyre nuk ishin të martuar zyrtarisht, kështu që babai nuk njihet si baba i fëmijëve. Por edhe gjyshërit biologjikë nuk mund të paraqiteshin në zyrën e gjëndjes civile pa dokumentat e nevojshme, të cilëve edhe materniteti nuk ju a ofronte. Të qenit të paegjistruar i privonte të miturit në përfitimin e disa shërbimeve të rëndësishme sociale e shëndetësore si vaksinimi, regjistrimi në kopshte apo shkolla, mospërfshirja në skemën e përfitimit të ndihmës ekonomike etj. E



gjitha kjo sepse të gjithë femijët e paregjistruar duke qënë pa identitet, janë edhe të padukshëm përpara ligjit, ata trajtohen sikur të mos ekzistojnë.

Se pari, TLAS nisi procedurat administrative për regjistrimin e fëmijëve. Duke qënë se prindërit e fëmijëve nuk kishin lidhur martesë dhe nëna nuk dihej se ku ishte, fëmijët u regjistruan në bazë të udhëzimit nr.7 datë 10.01.2012 "Për fëmijët e gjetur". Sipas këtij

udhëzimi fëmijët u regjistruan në certifikata familjare më vete në zyrën e gjëndjes civile, dhe ky ishte një hap shumë i rëndësishëm lidhur me të drejtën themelore të identitetit të fëmijëve.

Se dyti, TLAS nisi procedurat gjyqësore për dhënien e të miturve në kujdestari të gjyshërve biologjike, duke qënë se asnjëri nga të dy prindërit nuk ushtronte përgjegjësi në prinderore.



U deshën disa javë që të mblidheshin të gjitha provat e nevojshme për tu paraqitur në gjykatë. Pasi u administruan të gjitha provat shkresore u kërkuar nga gjykata të përgatiteshin dy akte ekspertimi, një akt ekspertimi psikologjik dhe një tjetër për vlerësimin e kushteve sociale të kërkuësve. Për këtë arsye u thirrën në gjykim dy ekspertë, një psikologe dhe një punonjëse sociale nga Bashkia e Tiranës. Të dy aktet e ekspertimit arritën në përfundimin se ishte në

interesin më të lartë të fëmijëve të vendoseshin në kujdestarinë ligjore të gjyshërve. Në përfundim gjykata pranoi kërkesën e avokatit të TLAS. Kështu, më në fund fëmijet e mitur sot janë të regjistruar me identitet dhe shtetësi si edhe kanë kujdestarët e tyre ligjorë, të cilët përgjigjen para ligjit për mbarëvajtjen dhe shëndetin e të miturve.

Marsida Male
Avokate e TLAS



Grupet e punës së studentëve të TLAS kanë organizuar këto Street Law gjatë 2015

Nr	Date	Vendi	Nr i përfituesve	Shpërndarje informacioni
1	13.01.2015	Durrës	50	100 botime, fletepalosje
2	24.02.2015	Durrës	68	120 botime, fletepalosje
3	10.02.2015	Tiranë	50	80 botime, fletepalosje
4	11.03.2015	Fush-Krujë	120	150 botime, fletepalosje
5	05.03.2015	Shkodër	100	120 botime, fletepalosje
6	06.03.2015	Durrës	50	120 botime, fletepalosje
7	28.04.2015	Elbasan	120	200 botime, fletepalosje
8	29.04.2015	Fier	50	90 botime, fletepalosje ure
9	18.05.2015	Kavajë	100	150 botime, fletepalosje
10	24.11.2015	Elbasan	100	200 botime, fletepalosje
11	04.12.2015	Durrës	50	100 botime, fletepalosje
12	16.12.2015	Tiranë	100	150 botime, fletepalosje
13	18.12.2015	Tirane	70	100 botime, fletepalosje
14	04.11.2015	Durres	60	80 botime, fletepalosje
15	21.12.2015	Berat	60	90 botime, fletepalosje
16	12.05.2015	Kukes	40	80 botime, fletepalosje
17	11.06.2015	Vlore	70	110 botime, fletepalosje
18	19.06.2015	Korce	60	100 botime, fletepalosje
	Total	18	1318 përfitues	2120 botime, fletepalosje



WORKSHOPE DHE SEMINARE - TLAS 2014

Seminare informuese dhe trainuese me punonjësit e njësive të institucioneve shëndetësore dhe ata të mbrojtjes së fëmijëve



Tiranë, 09 Shkurt 2015

Tema: "Plani Strategjik i TLAS
2015-2018"

Donator: CRD
22 Pjesëmarrës



Shkodër, 30 Tetor 2015

Tema: "Aktivizimi i organizatave me bazë komunitare dhe roli që ato kanë në mbrojtjen e të drejtave themelore të individëve dhe grupeve që përfaqësojnë".

Donator: CRD
23 Pjesëmarrës



Durrës, 26 Nëntor 2015

Tema: "Aktivizimi i organizatave me bazë komunitare dhe roli që ato kanë në mbrojtjen e të drejtave themelore të individëve dhe grupeve që përfaqësojnë".

Donator: CRD
29 Pjesëmarrës



Elbasan, 27 Nëntor 2015

Tema: “Aktivizimi i organizatava me bazë komunitare dhe roli që ato kanë në mbrojtjen e të drejtave themelore të individëve dhe grupeve që përfaqësojnë”.

Donator: CRD
25 Pjesëmarrës



Kavajë, 11 Dhjetor 2015

Tema: “Aktivizimi i organizatava me bazë komunitare dhe roli që ato kanë në mbrojtjen e të drejtave themelore të individëve dhe grupeve që përfaqësojnë”.

Donator: CRD
22 Pjesëmarrës



Gjirokastër, 23 Maj 2015

Tema: “Aktivizimi i organizatava me bazë komunitare dhe roli që ato kanë në mbrojtjen e të drejtave themelore të fëmijëve”.

Donator: UNICEF
19 Pjesëmarrës



Elbasan, më 28 Prill 2015

Tema : “Ngritja e kapaciteteve të organizatave komunitare për regjistrimet civile të familjeve dhe të fëmijëve të peregjistruar”.

**Donator: UNICEF
21 Pjesëmarrës**



Cërrik, më 22 05 2015

Tema: “Ngritja e kapaciteteve të organizatave komunitare për regjistrimet civile të familjeve dhe të fëmijëve të peregjistruar”.

**Donator: UNICEF
18 Pjesëmarrës**



Fier, më 27 08 2015

Tema: “Ngritja e kapaciteteve të organizatave komunitare për regjistrimet civile të familjeve dhe të fëmijëve të peregjistruar”.

**Donator: UNICEF
22 Pjesëmarrës**



Shkoder, me 22 06 2016

Tema: “Ngritja e kapaciteteve të organizatave komunitare për regjistrimet civile të familjeve dhe të fëmijëve të paregjistruar”.

Donator: Australian Embassy, Rome 22 Pjesëmarrës



Fush Kruje, me 21 06 2016

Tema: “Ngritja e kapaciteteve të organizatave komunitare për regjistrimet civile të familjeve dhe të fëmijëve të paregjistruar”.

Donator: Australian Embassy, Rome 21 Pjesëmarrës




Tiranë, me 23 06 2015

Tema: “Ngritja e kapaciteteve të organizatave komunitare për regjistrimet civile të familjeve dhe të fëmijëve të paregjistruar”.

Donator: Australian Embassy, Rome 21 Pjesëmarrës



STREET LAW NE SHITËPINË E FEMIJËS ZYBER HALLULLI



Roli i Psikologut dhe Punonjësit Social në Ekspertizën për Fëmijët në Palët Ndërgjyqëse.



Psikologu/punonjësi social në organet e drejtësisë, është dhe quhet ekspert i jashtëm. Si ekspert i jashtëm psikologu kërkohet dhe thirret nga gjyqtari i çështjes. Deri më sot gjykatat nuk kanë një listë paraprake të psikologëve, prandaj ligjërisht janë te hapura mundësitë për të gjithë psikologët/punonjësit social që kanë Diplomë Bachelor për Psikologji/Punë sociale edhe Diplomën Master për këto degë të përfaqësojnë klientin duke paraqitur raportin e vlerësimit para gjykatës.

Sigurisht qëllimi i këtij artikulli është të evidentojë disa nga metodat e taktikat e hartimit të raporteve vlerësuese nga psikologët, të theksojë rolin pa dyshim të rëndësishëm të këtij eksperti por edhe të ndikojë në përmirësimin e mëtejshëm të punës së tyre në të mirë të interesit më të lartë të fëmijës/ve dhe familjeve kujdestare.

Një përcaktim i plotë për përgatitjen e raporteve të vlerësimit psikologjik ofrohet nga udhëzuesi i publikuar për këtë qëllim dhe që

shërben si udhërrëfyes e model për armatën e psikologëve e punonjësve sociale. Udhëzuesi bazohet në Kodin e Familjes, të Procedures Penale dhe Civile, atje theksohet në mënyrë të vecantë se këta profesionistë duhet të kenë aftësi të mira komunikimi dhe njohuri të veçanta mbi Psikologjinë Ligjore dhe elementët psikologjik të procesit të marrjes në pyetje dhe atij të rrëfimit. Padyshim që sa më shumë thellohesh në procesin e njohjes së këndvështrimeve të psikologëve dhe përkatësisë gjinore apo fëmijëve përvijohet

fakti që që roli i psikologut është i rëndësishëm sepse ai ofron dhe duhet të ofrojë një shërbim sa konfidencial aq edhe të paanshëm përmes sigurimit të informacionit objektiv dhe kompetent në procesin e vlerësimit të interesave të femijës/ve dhe palëve ndërgjyqëse.

TLAS në procesin e rasteve gjyqësore ndeshet me disa kategori apo lloje ceshtjesh ku gjyqtari/ja kërkon ekspertizën e psikologut përpara se të marrë vendimin gjyqësor.¹ Më shpesh në TLAS janë



1 a) Ne rastet e zgjidhjes se martesës

- Duke u bazuar ne nenin 155 te kodit familjar ; para se sgjykata te mare nje vendim te perkoheshem ose perfundimtar lidhur me menyren e ushtrimit te pergjegjesis prinderore ,te drejtes se vizites ose te besuarit te femijes njerit ish- bashkeshort ,duhet te therras nje psikolog ose punonjes social ,I cili ,para se te jape mendimin ,duhet te marre te dhena per gjendjen material dhe morale te femijes ,kushtet ne te cilat jetojne dhe ku eshte me e pershtateshme te jetojne femija,Ne rast se gjykata arrin ne konkluzionin se femija,perkohesisht ,duhet ti besohet nje personi te trete ose nje familje kudestare duhet te marre mendimin e sektori-atit te ndihemes dhe sherbimeve sociale pran bashkise se vendit ku zhvillohet gjykimi.

b) Ne rastet e Kujdestarise

-Duke u bazuar ne nenin 267 te kodit familjar ;ne rast se nuk eshte caketuar kujdestar nga prindi qe ka ushtruar I fundit pergjegjesin prinderore ,gjykata I jep prioritet zgjedhjes se kujde-

ndeshur rastet që kanë lidhje me nevojën për kujdestari të fëmijes ose për rregullime apo detyrime të tjera prindërimi dhe që ndermerren brënda disa konteksteve të ndryshme ligjore, si:

- gjate procesit te nje zgjidhjeje martese (divorci),
- procesit te heqjes se pergjegjesise prinderore kur e drejta prinderore eshte e ezuarur,
- gjate procesit te caktimit te kujdestaritligjor në rastet e braktisjes, abuzimit apo neglizhimit,
- gjatë procesit të urdhërit të mbrojtjes

starise midis paraardhësve ,personave te afert te te miturit nje familje kujdestare dhe si alternative te fundit insitucioni publik ose privat,para se gjyqtari te caktoj kujdestarin duhet te degjoj personin e zgjedhur sit e tille he te marre mendimin e te miturit nese ai ka mbushur moshen dhjete vjec.Gjykaata ne cdo ras,merr mendimin e sektorit te ndihmes dhe sherbimeve sociale prane bashkis ose komunes se vendit ku zhvillohet gjykimi,l cili permban ekzaminimin e zhvillimit te personalitetit te femijes ne kontekstin familjar edukativ e social dhe ekzaminimin e kushteve dhe pershtatshmeris se femijes kujdestarit nga gjykata behet duke pare cilsite e personit kujdestarte ardhshem ,te familjes kujdestare ose institucionit te perkujdesjes .caktimi l kujdestarit nga gjykata behet duke pare cilesit e personit kujdetstar te familjes kujdestare te zgjedhur ose te institucionit te perkujdesjes sipas patragrafit te tret te ketij neni si dhe pasi ka degjuar mendimin e nje psikologu,qe duhet te jete i pranishem gjat gjykimit.

c) Ne rastet e ushtrimit te pergjegjesise prinderore

-Duke u bazuar ne nenin 224 te kodit familjar ;ne qofte se prinderit e femijes kane vdekur jane ne pamundesi te ushtrojne pergjegjesin prinderore per shkak te pazotesis per te vepruar ,te mungeses ose per arsye vecanerisht te renda,femija mund ti besohet nje antari te gfamiljes kujdestare ose edhe nje institucioni te perkujdesjes. Nekete rast merret mendimi l sektorit te ndihmes dhe sherbimeve sociale,sipas dispozitave per kujdestarine



Bazuar në eksperiencën e rasteve të përfaqësuar në gjykatë nga TLAS në rrethet Tiranë, Elbasan, Fier, Durrës, Krujë dhe Lezhë, etj. gjate 5 viteve të fundit², mund të pasqyrojmë numrin e çështjeve të trajtuara, pjesmarrjen e psikologut me raporte vlerësuese në procesin gjyqësor, dhe sigurisht punën me palët ndërgjyqëse dhe fëmijët e tyre si më poshtë:



Nr	Viti	Zgjidhje Martese(Divorc)	Kujdestari	Përgjegjësi Prindërore	Psikolog i përgjithshëm	Punonjës social
1	2011	96	76	13	95%	5%
2	2012	153	87	21	93%	7%
3	2013	113	56	24	94%	6%
4	2014	135	66	28	94%	6%
5	2015	137	50	17	98%	2%
total	1072	634	335	103	95%	5%

Tabela tregon se TLAS ka grumbulluar një experiencë të gjërë për të gjitha rastet e mësipërme ku roli i psikologut dhe raporti i tij i vlerësimit

² Të dhënt kanë si burim data bazen e TLAS, shume profesionale ne fushen e sherbimeve ligjore, e instaluar nga John Camps, USA, qe ne vitin 2000. Puna me klientet, avokatet, psikologet apo eksperte te tjere eshte e pasqyruar ne kohe dhe me detaje per secilin vit, ceshtje, me te dhena personale per klientin, adresen, kontaktet dhe rezultatin e mbylljes se rastit.

it është kërkuar nga gjykata me synimin e sigurimit të një kujdesi sa më të mirë ndaj fëmijës/ve.

Për të qënë sa më konkret por edhe përgjithësues në të njëjtën kohë, u studjuan rreth 50 raporte vlerësuese që u takojnë 50 rasteve të përmendura në tabelë, të hartuara nga 10 psikologë të ndryshëm, 4 prej të cilëve an-



gazhohen në gjykatën e shkallës së parë në Tiranë, dhe 6 të tjerë në gjykatat e shkallës së parë në Durrës, Fier, Elbasan, Lezhë dhe Krujë . U bënë disa intervista me palët ndërgjyqëse që aktualisht kanë rastet e tyre të përfaqësuar nga avokatët e zyrës. Raportet Vlerësuese të përzgjedhura, kopjet e të cilëve janë të depozitaura në arkivën e TLAS, u shqyrtuan me vëmendje me synimin:

- Sa ka arritur psikologu të demonstrojë qellimin e raportit të vlerësimit
- Si dhe sa është argumentuar roli dhe sjellja e secilit prind
- Sa vëmendje i kushtohet sqarimit të palëve në process
- A ka patur raste të keq përdor-

imit të influencës së psikologut përmenden

- Shkalla e diversitetit të raporteve të vlerësimit nga psikologë të njëjtë dhe të ndryshëm për çështje të njëjta e të ndryshme
- Roli i kualifikimit apo nivelit profesional si vlere e shtuar në cilësinë e raportit të vlerësimit dhe në ndikimin apo influencën për marrjen e një vendimi gjyqësor në favor të interesit me të lartë të fëmijës.

Del se sot mungon një urdhër i përcaktuar qartë për mënyrën e caktimit të psikologut, për shkallën e kualifikimit të tyre dhe për punonjësin social po ashtu. Gjithashtu del se është e lehtë për një psikolog që punon në organet e drejtësisë të dallojë në palët ndërgjyqëse prindërit apo bashkëshortët që vuajnë nga probleme mendore apo çrregullime të personalitetit, që janë manipulues, individualist apo egoist dhe që si rezultat duan të imponojnë mendimet e tyre në hartimin e raportit vlerësues. Nga intervistat me palët ndërgjyqëse dhe praktikantët e sotme para dyerve të gjykatave³

³ Ky fenomen i ka ndodhur edhe avokatëve të TLAS në rastet kur çështja gjyqësore është në rrethë të tjera të vendit jashtë Tiranës



pjesa më e madhe e psikologëve nuk kanë zyra apo ambiente të përshtatshme për të ndjekur të gjitha procedurat apo plotësuar kërkesat e gjykatës lidhur me hartimin e Raportit të Vlerësimit. Kryesisht psikologët i kryejnë takimet me palët ndërgjygjëse në ambiente publike si: Bare, Lokale, Ambjentet e Gjykatës, ose ambiente të tjera të papërshtatshme dhe që cënojnë parimin bazë të vlerësimit, atë konfidencial. Si rezultat cilësia e raportit të vlerësimit që Psikologu “dorëzon” tek gjyqtari / ja i/e cështjes është i diskutueshëm për faktin se:

ku Zyra e TLAS siguron kushtet me të mira për punën e psikologut me fëmijet dhe palët.

- Palët ndërgjygjëse përballen me pranimin e personave të tjerë të cilët e cënojnë seriozitetin dhe besueshmërinë e procesit.
- Shkalla e transparencës dhe e sinqeritetit të palëve është e ndikuar detyrimisht nga ambjenti që i rrethon. Ata individë object i intervistave që janë timidë ose të turpshëm apo të mbyllur si karaktere, nuk arrijnë të shprehin c'ka ndjejnë sepse hutohen ose coroditen, ndërsa ata që janë tinzarë përfitojnë nga rasti për të aplikuar teknikat e manipulimit apo të shtirjes.
- Po ashtu zhurmat e ambjentit rrethues e degradojnë intervistën në një bisedë të zakonshme, bisedë “kafeje”, shumë larg teknikave të domosdoshme profesionale.
- Palët dhe fëmijët e interesuar për raportin e vlerësimit, por edhe vet psikologu nuk ka si të ndihen rahat në ambjentet publike të papërshtatshme. Dhe jo rrallë bëhet një punë shkel e shko, për të kaluar rradhën, për të marrë shpërblimin, pa cka se raporti i vlerësimit është i përgjithshëm dhe i përciptë, ai është pranueshëm nga gjyqtari.

- Del se procesi në këto raste është më shumë një formalitet për palët, psikologun dhe gjyqtarin që detyrimisht në bazë të ligjit duhet të arkivojë raportin e vlerësimit, por nga ana tjetër është po ashtu edhe një burim i lehtë financiar për psikologët, është mungesë profesionalizmi nga ana e tyre dhe barrë financiare e rëndë për palët me të cilat merret Shërbimi Ligjor Falas.

- Dihet që pagesa e psikologut si ekspert i jashtëm, mbulohet nga pala e cila ka ngritur padinë në gjykatë dhe psikologët i referohen udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë për pagesën e ekspertit, maksimumi i të cilit është 40000 lekë. Pothuaj të gjithë psikologët, pavarësisht nga koha apo cilësia e punës që bëjnë tentojnë të kërkojnë maksimumin e vlerës duke ju referuar j udhëzimit nr 4, datë 12.12.2012, të qeverisë, dhe sigurisht duke gjetur mbështetjen e gjyqtarit/es. Dihet që nëse palët ndërgjyqëse merren vesh me njëri tjetrin për kërkesat ndaj fëmijës, raporti vlerësues i psikologut mund të shmanget, gjë që nuk aplikohet pothuaj fare nga gjykata. Ka patur Jo rallë raste kur

palët e interesuara për një raport vlerësues cilësor kërkojnë takime të posacme me psikologun, adresa e zyrës se të cilit nuk gjenet, apo telefoni nuk hapet, apo emaili nuk ofrohet.

DISA GJETJE

Në përgjithësi raportet karakterizohen nga e njëjta skemë dhe qëllim vlerësimi ku përfshihen: përcatimi i faktorëve individuale dhe familjare që ndikojnë interesat më të mira të fëmijës/ve, përcaktimi i faktorëve që do të sigurojnë mirëqënien e tyre, përcaktimi i kapacitetit prindëror në kontekstin e perspektivës së kujdestarisë si dhe



mos argumentimi i plotë i nevojave dhe dëshirave të çdo fëmije.

Del se rreth vetëm 15 % e Psikologëve përpiqen të sigurojnë informacionin më specifik për gjykatën. Raportet e tyre janë më të dobishme dhe më influencuese sepse pasqyrojnë të dhënat reale, të duhuara, mangësitë, vlerat dhe tendencat e prindërimit dhe specifikisht nevojat psikologjike të fëmijës.

Dhe rreth 75 % e psikologëve nuk thellohen në vlerësimet e tyre, ose ata ofrojnë thjesht një tablo të situatës apo shkaqeve pa tentuar të

rendisin pasojat që do të rezultojnë në këtë kontekst. Logjikisht dhe krahasimisht këto lloj raportesh vlerësuese duhet të kenë më pak peshë ose të mos influencojnë si duhet në vendimet e gjykatës. Në këto raporte vlerësuese del qartë që psikologu rrallë i referohet procedurave apo standarteve ligjore të aplikuara perfshi legjislacionin perkates te rastit.

Duke qënë se rastet që janë studjuar i përkasin familjeve më vulnerabël të shoqërisë dhe kryesisht komunitetit Rome dhe Egjyptian duhet theksuar se Psikologet duhet të jenë të më të ndërgjegjshëm për të aplikuar praktika jo diskriminuese e jo paragjyquese për moshën, racën, etnitetin, origjinën, paaftësinë, gjuhën, kulturën apo statusin socioekonomik, për të ndërhyrë më ndjeshëm në objektivat e vlerësimit dhe në rekomandimin para vendim marrjes.

Ka raste kur në raportet e vlerësimit nuk pasqyrohen detaje të rëndësishme të aftësive të fëmijëve si ato konjitive, sjellore, mendore apo sociale. Nga studimi del se



vlërësimet mendore, shtrembërimet konjitive, prania ose mos prania e deluzioneve apo crregullimeve të ankthit, stresit, gjëndjeve emocionale, konceptimeve të deformuara, etj. nuk merren në konsideratë ose bëhen të cuniguara, të pa argumentuara apo adresuara.

Një gjetje tjetër gjetje e studimit të raporteve vlerësuese lidhet me të ashtuquajturin Ekzaminimin e Statutit Mendor të palëve, ose ESM, si një nga procedurat profesionale që psikologu ka detyrimin të përcaktojë. Me sa duket vlerësimi e elementëve që përmban ESM është i vështirë dhe shumica e Psikologëve, duket sikur përsërit të njëjtën situatë, ndryshojnë vetëm emrat e palëve ndërgjygjëse dhe tek tuk ndonjë fjalë.

Në më shumë se 60 % të raporteve të studjuara të duket sikur vlerësohet i njëjti fëmijë, të njëjtët prindër, vetëm se ndryshojnë emrat, adresat apo mosha e vendndodhja. Në këto raporte interesi më i lartë apo më i mirë i fëmijës duket i përdorur më shumë si një slogan

i përsëritur në vlerësimet shabllone se sa i konkretizuar me realitetin specifik para dhe pas zgjidhjes së çështjes. Ka raste kur raporti vlerësues i depozituar nuk ka informuar apo përcjellë realitetin pas fasedës në dukje, para vendim marrjes së gjykimit.

DISA KONKLUSIONE E REKOMANDIME

Nisur nga ngjashmëria e raporteve vlerësuese në çështjet gjyqësore të përmendura më sipër del si rekomandim që psikologët e përfshirë në sektorin



e drejtësisë kanë nevojë të trajnohen e kualifikohen më tej për të pasuruar eksperiencën, metodën e vlerësimit, përsosur gamën e pyetjeve që bëjnë në përputhje me karakteristikat dhe tipologjinë e individëve të përfshirë si dhe me specifikën e çështjeve.

Raportet vlerësuese të psikologëve duhet më mirë të përmbajnë dhe interpretimet e bazuara në ligj pikërisht ato që rregullojnë kombinimin e kapaciteteve të prindërimit me atë të mbrojtjes dhe nevojave për

përkujdesje të femijëve; të përmbajnë propozime për ndërhyrje bazuar në skemat ekzistuese sociale që ju ofrojnë prindërve njohuri të nevojshme për të siguruar mbështetje dhe kujdes të mjaftueshëm për fëmijën

Roli i psikologut është ai i një experti profesional që synon të arrijë objektivat e përmendura më sipër dhe të reprojektojë qëndrimin e paanshëm. Psikologu nuk vepron si gjyqtar që jep vendimin përfundimtar bazuar në ligj dhe në provat e paraqitura. Po kështu ai nuk





vepron si një avokat mbrojtës që përpiqen të gjejnë sa më shumë dokumenta para gjykatës. Psikologu në mënyrë të paanshme dhe të ballancuar informon dhe keshillon gjykatën dhe kujdestarin e ardhshëm të fëmijes për faktorët psikologjik që ndikojnë çështjen e kujdestarisë

Psikologu para se të performojë vlerësimin duhet t'i referohet më mirë literaturës dhe njohurive rast pas rasti sepse backgroundi i familjeve është relativisht i ndryshëm nga njeri tjetri. Kompeten-

cat profesionale të psikologëve duken se janë të pa mjaftueshme. Kualifikimet, trainimet, eksperiencat e ngjashme, dhe vëzhgimi i ambjenteve të fëmijëve, i psikopatologjive familjare, matja e impaktit të divorcit të fëmijët, të gjitha këto duhet të ndihmojnë në mënyrë më të ndjeshme për përparatjen e vlerësimeve.

Çështjet e zgjidhjeve të martesës që përfshijnë të mitur, apo dhe ato familjare që janë pazgjidhmërisht të lidhura me të parën, kanë rreze shumë më të gjërë

nga sa përmendin aktet dhe në përgjithësi legjislacioni përkatës, ato janë shumë të nxehta edhe kur shfaqen si të ftohta akull, vendimet e tyre nuk lënë gjurmë vetëm në letër, ato lënë gjurmë të thella në jetët e shpirtrat e njomë të krijesave më të pafajshme. Prandaj zgjidhjet dhe jo vetëm nënkuptojnë post zgjidhjen, si do të funksionojnë urat e komunikimit, si dhe kush do ushtrojë kujdestarine, mbështetjen financiare, rugët e sigurimit të mireqenies së fëmijës/ve, mënyrat e vlerësimit të kësaj situate, vizitat dhe

vendqendrimin apo çështje më e rëndësishme ushtrimin e të drejtave prindërore.

Një rekomandim tjetër është se ka ardhur momenti dhe lindur nevoja për kategorizimin apo specializimin për grupe çështjesh të psikologëve të punësuar në organet e drejtësisë psh ata që do të punojnë me çështjet e divorcit, kujdestarisë, përgjegjësisë prindërore; me vlerësimet për shpërblime dëmi; vlerësimin e dëmit të shëndetit apo psikologjik shkaktuar për çështje të ndryshme etj. Trainimet klinike të psikologëve që angazhohen me çështjet gjyqësore duhet të synojnë më mirë në perfeksionimin e teknikave investigative të tyre në të gjithë faktorët që përcaktojnë kushtet, statusin dhe kapacitetet, dinamikën e familjes dhe komunikimin; mjedisin kulturor, sjelljet e palëve dhe mbi të gjitha nevojat e mirëqënies fizike, edukative dhe psikologjike të fëmijëve.



Vilma Gjeci
Psikologe e TLAS

**SHËRBIMI
LIGJOR FALAS
TIRANË
NË VITIN 2015**

TLAS

